

VENDIM
Nr. 232, datë 21.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1093, DATË 28.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, TË KRITEREVE DHE PËRPARËSIVE PËR DHËNIEN E BONUSIT TË STREHIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 14, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1093, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shitesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 6, e vendimit, ndryshon me këtë përmbajtje:

“6. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 30 maj të çdo viti, paraqesin pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit kërkesat për bonus strehimi, sipas shtojcës A, të këtij vendimi, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje, si dhe listën e detajuar të familjeve përfituesve.”.

2. Pas pikës 9/1 shtohet pika 9/2, me këtë përmbajtje:

“9/1. Përgjashtimisht për vitin 2017, edhe në rastet kur njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë fonde të miratuara në buxhetin e tyre për bonus strehimi, buxheti i shtetit do të përballojë deri në 50 për qind të qirasë, ndërkohë që pjesën e mbetur e përballon qytetari që përfiton bonusin e strehimit.”.

3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama